

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PJESËMARRJES SË FËMIJËVE

BOTIM MIQËSOR PËR FËMIJËT



KRITERET E PËRGJITHSHME TË PJESËMARRJES SË FËMIJËVE, SHPREHUR NË GJUHËN E FËMIJËVE

Autor:

Suela Bala, Ekspert

Grupi i punës në Save the Children

Blerina Çeloaliaj- Drejtore Programi

Edlira Ngjeci- Manaxhere Programi

Sabina Çarçani - Specialiste Tematike

Iva Korumi - Oficere Programi

Tiranë, 2020

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne besojmë se çdo fëmijë meriton një të ardhme të mirë. Në botë dhe në Shqipëri, Ne ndihmojmë fëmijët të kenë një fillim të mbarë në jetë, mundësi për të mësuar dhe mbrojtje ndaj çdo rreziku. Ne bëjmë më të mirën për fëmijët - çdo ditë dhe në kohë krize -për të sjellë ndryshime në jetën e tyre dhe të ardhmen e përbashkët.

Ky udhëzues publikohet në kuadër të projektit "Nga Fëmijët për Fëmijët", financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar dhe zbatuar nga Save the Children në bashkëpunim me Zyrën e Avokatit të Popullit dhe Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

@Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave, të përmendura më lart, si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

FALENDERIME

Mirënjohje dhe falenderim i veçantë u shkon të gjithë fëmijëve që morën pjesë në konsultime si dhe anëtarëve të grupimit "Zëri 16+..." në Durrës, Peshkopi, Burrel dhe Elbasan, të cilët kanë sjellë zërin e tyre dhe të bashkëmoshatarëve në këtë proces. Në këtë botim dedikuar fëmijëve, ata kanë ndarë këndvështrimin e tyre mbi kuptimin e kritereve të pjesëmarrjes si dhe përvoja konkrete gjatë punës së tyre me grupin e udhëhequr nga fëmijët "Zëri 16+...", apo veprimtari të ndryshme ku ata kanë qenë pjesëmarrës.

Grupi i Punës në Save the Children

Përmbajtja

1. Hyrje

2. Si u ndërtua puna për realizimin e këtij materiali?

3. Çfarë është pjesëmarrja e fëmijëve dhe pse është e rëndësishme ajo?

4. Kriterete përgjithshme të pjesëmarrjes së fëmijëve shprehur në gjuhën e fëmijëve.

5. Fushat ku duhet dhe mund të marrin pjesë fëmijët

6. Bibliografia

HYRJE

Siç ju miq e dini, Save the Children dhe Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve me mbështetjen e Ambasadës Suedeze, kanë hartuar një dokument udhëzues shumë interesant dhe të rëndësishëm që është titulluar "Kriteret e Përgjithshme të Pjesëmarrjes së Fëmijëve."

Ju e dini, e drejta e pjesëmarrjes është një nga parimet themelore të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, ndaj dhe ky dokument u vjen në ndihmë të rriturve që punojnë me dhe për fëmijët kudo qofshin ata, të realizojnë një pjesëmarrje sa më të drejtë në interes të zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijëve.

Pavarësisht se "Udhëzuesi praktik për Kriteret e Përgjithshme të Pjesëmarrjes" është një dokument i cili u drejtohet të rriturve, profesionistëve, politikbërësve, studiuesve, punonjësve të organizatave që punojnë me fëmijët, është e rëndësishme që përmbajtja e tij të kuptohet mirë dhe të njihet edhe nga fëmijët në mënyrë që Ju vetë të kërkonti të plotësohen këto kritere kur bëheni pjesë e aktiviteteve apo kur ju kërkohet të jepni mendime e të shprehni opinione mbi çështje të rëndësishme për ju.

Për këtë arsye, botimi që tashme keni në dorë, është rishkruar në një gjuhë miqësore për të gjithë fëmijët dhe risjellë i thjeshtëzuar dhe me shembuj praktik të prezantuar nga shokët dhe moshatarët tuaj, që të jetë sa më i kuptueshëm dhe i përdorshëm për ju. Këtu janë paraqitur disa parime pune me fëmijët që të rriturit duhet t'i kenë parasysh si dhe 9 kriteret që na sigurojnë se përfshirja e fëmijëve bëhet me cilësinë e duhur dhe është një proces i vlefshëm si për fëmijën ashtu edhe për të rriturit. Ndaj dhe ju ftojme të lexoni këtë variant të rishikuar, me shpresën se do ju ndihmojë në veprimtaritë tuaja, dhe se ju vetë do bëheni nxitësit kryesorë të zbatimit të tyre.

Lexim të këndshëm!

SI U NDËRTUA PUNA PËR REALIZIMIN E KËTIJ MATERIALI?

Hartimi i botimit miqësor për fëmijët të "Udhëzuesit praktik për Kriteret e Përgjithshme të Pjesëmarrjes" ka kërkuar një përfshirjen dhe angazhimin e disa grupeve të fëmijëve. Kjo ka ndodhur në tre drejtime;

- 1) Grupet e fëmijëve u përfshinë në sesione informimi dhe orientimi ku u shpjegua udhëzuesi praktik i lartpërmendur;
- 2) U punua me secilin prej grupeve për të zbërthyer emërtimin e kriterit në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për fëmijët e të gjitha moshave dhe grupeve;
- 3) Kriteret e rishkruara u prezantuan në një sesion të përbashkët me të gjithë grupet dhe u pasuruan me shembuj konkretë.



Hapat e punës

Fëmijët u ftuan në proces përmes postës elektronike, duke shpjeguar aktivitetin, objektivat dhe çfarë do duhej të bënin. Ata u njoftuan se pjesëmarrja ishte me vullnet të lirë dhe mund të tërhiqeshin nga ky angazhim kurdo që e konsideronin të nevojshme. Ata u sqaruan se konsultimet do të ndodhnin përmes platformës ZOOM në internet dhe u pajisën me informacionin e duhur për një përdorim të sigurt të internetit. U krijuan 4 grupe pune nga fëmijët e "Zërit 16+..." në Elbasan, Tiranë, Durrës dhe Burrel. Krijimi i grupeve mori parasysh ashtu si dhe herë të tjera përfshirjen e fëmijëve nga zona të ndryshme, mosha të ndryshme (mes 10 - 14 vjeç) dhe një paraqitje e barabartë mes vajzave dhe djemve të angazhuar. Secilit grup iu nda një pjesë nga Udhëzuesi, i cili u diskutua me ndihmën e lehtësuesit të rritur. Në përfundim secili grup solli një variant të thjeshtëzuar të Udhëzuesit më të kuptueshëm për fëmijët. Gjithashtu, grupet përzgjedhën edhe disa raste ilustruese nga eksperiencia e tyre gjatë aktiviteteve pjesëmarrëse.

E.Xh. Katund i Ri



"Ka vendime për të cilat nuk vendosim ne fëmijët, por në rastet kur ka vendime të vogla, pyetemi edhe ne"

K.C Burrel



"Edhe ata që bëjnë konsultime duhet të jenë pak më të përshtatshëm, pak më të qartë me fëmijët. Duhet të dinë se si ta bëjnë bashkëbisedimin, t'i shtynë fëmijët që të japin ide sa më të shumta, pa pasur frikë"
- K.C Burrel

ÇFARË ËSHTË PJESËMARRJA E FËMIJËVE?

Pjesëmarrja është ndër parimet themelore të **Konventës së të Drejtave të Fëmijëve** miratuar nga **Organizata e Kombeve të Bashkuara** në vitin **1989** dhe **ratifikuar nga Shqipëria** në vitin **1992**.



Neni 12 -të i Konventës së të Drejtave të Fëmijëve përcakton se: E drejta për të shprehur mendimin në çështjet që lidhen me fëmijën

1. Fëmija ka të drejtë të thotë lirisht mendimin e tij. Shteti ua siguron këtë të drejtë të gjithë fëmijëve që mund të kenë mendime.

2. Kjo bëhet që fëmija të dëgjohet në çdo vend ku merren vendime për të, në Gjykatë ose diku tjetër. Mund të ndodhë që fëmija nuk mund të jetë atje. Atëherë mendimin e tij mund ta shprehë një njeri që me ligj kujdeset për të, kur fëmija nuk ka prindër.

Neni 5: "Udhëheqja prindërore dhe zhvillimi i aftësive të fëmijës" Shteti duhet të respektojë të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ndaj fëmijës. Kjo qëndron edhe për njerëzit që me ligj kujdesen për fëmijën. Ata duhet t'i mësojnë fëmijës të zbatojë të gjitha të drejtat dhe detyrat e tij të shkruara në Konventë. Kjo bëhet sipas moshës dhe mundësive të fëmijës.

Neni 13: "E drejta e shprehjes në të gjitha mënyrat Fëmija ka të drejtë të thotë mendimin e tij me fjalë, shkrim, vizatim, vjersha, skeçe të ndryshme etj. Kjo do të thotë që fëmija ka të drejtë të kërkojë, të marrë dhe të japë lajme e mendime të ndryshme. 2. Ndodh që kjo e drejtë të ndalohej. Kjo ndalohej që të respektohen të drejtat dhe liritë e njerëzve.

Pjesëmarrje e fëmijëve do të thotë që fëmijët kanë të drejtë të dëgjohen, të shprehin mendimin dhe të influencojnë vendimet që i prekin drejtpërdrejt duke u bërë pjesë në arritjen e ndryshimit. Pjesëmarrja e fëmijëve është një përfshirje e informuar dhe e vullnetshme e të gjithë fëmijëve, përfshirë ata me aftësi ndryshe, ata që mund të gjednen në situata me rrezik, vajza apo djem, të besimeve fetare të ndryshme në çdo çështje që lidhet me ta drejtpërdrejt ose jo. Pjesëmarrja e fëmijëve është një vlerë që prek të gjitha programet dhe zhvillohet në të gjitha fushat, nga familja, shkollat, institucionet qeveritare, nga institucionet lokale në ato ndërkombëtare.

Nenet e tjera të **KDF** që lidhen me pjesëmarrjen e fëmijëve përfshijnë **Nenin 13** që njeh të drejtën e fëmijës për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacion dhe mendim të çfarë do lloji dhe **Nenet 14, 15, 16, 17**, të cilat sigurojnë të drejtën e fëmijës për lirinë e shprehjes, mendimit, ndërgjegjes, besimit fetar, grumbullimit paqësor, mbrojtjes së privatësisë dhe aksesin në informacion dhe **Nenin 23** që u jep fëmijëve me aftësi të kufizuara të drejtën për pjesëmarrje në komunitet dhe **Neni 2** që siguron zbatimin e gjithë çfarë parashtrohet në konventë për çdo fëmijë.

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PJESËMARRJES SË FËMIJËVE, SHPREHUR NË GJUHËN E FËMIJËVE.

Pjesëmarrja e fëmijëve është:

- 1) Transparente dhe informuese për të gjithë
- 2) Llogaridhënëse
- 3) E sigurtë
- 4) Pjesëmarrja është relevante/domethënëse/e përshtatshme
- 5) Bazuar në respektin e ndërsjelltë
- 6) Vullnetare
- 7) Miqësore me fëmijët
- 8) Gjithëpërfshirëse
- 9) Mbështetet nga të rritur miqësorë dhe të mirë informuar

Që ju të ndiheni mjaftueshëm të qartë mbi zbatimin e këtyre kriterëve, secili prej tyre është shoqëruar me një listë pyetjesh të cilat ju mund t'i diskutoni me bashkëmoshatarët tuaj apo dhe me të rriturit që lehtësojnë proceset pjesëmarrëse.

Mos hezitoni asnjëherë të kërkonit informacion - të kërkoksh të dish nuk është turp.



Kriteri #1- Pjesëmarrja është transparente dhe informuese për të gjithë

Përshkrimi i kriterit:

“Fëmijët kanë të drejtë t'u shpjegohet çdo aktivitet ku ata marrin pjesë dhe t'u shpjegohet cili është roli i tyre në këtë aktivitet. Kjo ndihmon të kuptojmë më mirë dhe të japim më të mirën tonë. Këto informacione duhet t'u jepen gjithashtu edhe prindërve tanë që edhe ata të jenë të qetë, të sigurtë dhe të na mbështesin në angazhimet tona.”





Unë jam **Fiona Dinollari** dhe mund të them se përgjatë aktivitetit si vullnetare në **Zërin 16+** Durrës, kriteri i parë i pjesëmarrjes është zbatuar plotësisht.

Me rregulla të përcaktuara mirë, të cilat i janë përcjellë fëmijëve dhe prindërve të tyre gjatë viteve të veprimtimit në organizatë, të gjithë kanë qenë të informuar në lidhje me aktivitetet, mënyrën se si operohet dhe cilat kanë qenë të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve si vullnetarë. Gjithashtu, nuk kanë munguar edhe lejet e firmosura nga prindërit në lidhje me përdorimin e imazhit dhe zërit të fëmijëve, duke i vendosur ata në një pozicion të mbrojtur nga abuzimet. Gjithashtu, janë vendosur gjithmonë afate të caktuara pune. Me anë të organizimit paraprak të aktiviteteve, të parashikuara fillimisht në planin vjetor ose të lajmëruara më parë nga organet e organizatës, kemi patur të mundur të kemi një progres pune që na e ka bërë të thjeshtë orientimin ndërmjet eventeve të ndryshme. Nuk duhet harruar se vetë filozofia e grupit e cila ka sjellë përfitime të mëdha të fëmijëve vullnetarë. Megjithatë roli i lehtësueses ka qenë gjithnjë sa i pranishëm edhe i rëndësishëm, fëmijët kanë qenë ata që kanë marrë vendime dhe iniciativa në lidhje me aktivitetet që do të bëheshin si dhe nismat që do të ndërmerreshin. Ata kanë identifikuar nevojat dhe kanë ndërmarrë veprime që me konsultimet me të rritur, i janë dukur më të arsyeshme dhe të realizueshme. Kjo nuk do të thotë se ishin të rriturit ata që vendosnin, por ata kanë shërbyer si këshillues dhe informues në lidhje me situatat dhe mundësitë që mbeteshin për t'u konsideruar. Për sa i përket materialeve, ato janë paraqitur në gjuhën shqipe gjithmonë për t'u lehtësuar punën fëmijëve. Duhet theksuar se ka patur dhe të tilla të cilat kanë qenë në gjuhën e fëmijëve, si psh: Konventa e të Drejtave të Fëmijëve, që ka qenë një shoqërues i përhershëm në punën e tyre. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e fëmijëve ka qenë transparente. Në bazë të aktivizimit me punën në grup, është bërë e mundur gjithmonë që për aktivitete të ndryshme të zgjidhen fëmijë të votuar nga grupi të cilët kanë bërë një punë të mirë dhe kanë dhënë kontribut të vlefshëm për punën në grup. **Zëri 16+ Durrës**

Pyetje ndihmëse:

- A është materiali i përgatitur në një gjuhë të kuptueshme për ju?
- A jeni informuar rreth të drejtës tuaj për t'u shprehur lirisht?
- A janë informuar prindërit ose kujdestarët tuaj, në lidhje me qëllimin dhe si ndikon ky proces?
- A është diskutuar dhe rënë dakord me Ju qëllimi, mënyra e organizimit dhe rezultatet e pritshme?



Kriteri #2 - Pjesëmarrja është miqësore me fëmijët

Përshkrimi i kriterit:

“Ndonjëherë na thërrasin në aktivitete dhe ne nuk kuptojmë gjë. Sidomos kur kërkohet mendimi ynë, ne duhet të kuptojmë siç duhet për çfarë bëhet fjalë. Të rriturit që janë në kontakt me ne dhe që organizojnë aktivitetet duhet të dinë të komunikojnë me fëmijët. Jo vetëm fjalori të jetë i përshtatshëm por ne duhet të ndihemi rehat, të vlerësuar, të kemi mundësi të bëjmë pyetje pa frikë dhe të marrim përgjigjet e duhura që të kuptojmë siç duhet dhe të kemi mundësi të japim më të mirën tonë.”





Unë jam **Erka Tana** dhe një nga fjalët kyçe me të cilën do ta lidhja përfshirjen time në grupin e udhëhequr nga fëmijët "**Zëri 16+...**" është pjesëmarrja miqësore me fëmijët, që e bën atë të jetë domethënëse. Ky ka qenë një term për të cilin jo vetëm është advokuar por dhe vetë grupi është bërë shembull i tij. Arsyeja pse anëtarët e aktivistët e rinj të grupit arrijnë fare lehtë ta dallojnë se kur një pjesëmarrje është domethënëse, lidhet si fillim me gjuhën me të cilën koordinatori e grupit, kontakti ynë i parë me "**Zërin 16+**", komunikon me ne. Nëse dikush të flet në gjuhën tënde, ti e di se ai po kërkon realisht të komunikojë me ty, po kërkon që ti ta kuptosh e që ai të të kuptojë e këtë urë komunikimi e kam ndjerë të pranishme përgjatë të gjithë përfshirjes sime në aktivitetet e grupit. Pra grupi jo vetëm që e ka gjenezën e tij e ka tek të përkthyerit e dokumentave si Konventa e të Drejtave të Fëmijëve në një gjuhë të kupteshme për ta, por dhe e ka konkretizuar këtë mision në vazhdim duke u folur gjithnjë fëmijëve në gjuhën e tyre. Trajnimet ishin sa informuese, aq dhe argëtuese sepse ndërthurnin teorinë me praktikën ku për të hartuar një plan advokimi, na duhej të ndërtonim pemën me në trung qëllimin tonë madhor, në rrënjë shkaqet e në degë pasojat përkatëse që më pas i përkthenim në nën-objektiva të planit tonë të advokimit. Për t'u siguruar që zëri i të gjithë fëmijëve të reflektohej në raportet e shkruara, pyetësorët mbi prolematikat që na shqetësonin si ato të I Qeshorit apo të Raportit Periodik Universal, hartoheshin në bashkëpunim me fëmijët e grupeve të të katërta qyteteve e fëmijë të grupeve të tjera, më pas shpërndareshin në shkolla të ndryshme të vendit në përmbyllje analizoheshin në bashkëpunim me fëmijët, që do të ishin po vetë ata që do t'i prezantonin gjetjet në konferencat periodike, pra ne kishim kurdoherë akses të të gjitha fazave të procesit të shkrimit të raporteve. **Zëri 16 + Elbasan**

Pyetje ndihmëse:

- A është vendi i mbledhjes i përshtatshëm dhe i aksesueshëm për të gjithë fëmijët?
- A janë planifikuar mjaftueshëm pushime ndërmjet sesioneve në agjendë?
- A është i gjithë informacioni dhe procesi i pjesëmarrjes/konsultimit i kuptueshëm, dhe i përshtatshëm për grupmoshën e përzgjedhur?



Kriteri #3 - Pjesëmarrja është llogaridhënësë

Përshkrimi i kriterit:

“Neve na ka qëlluar që kemi marrë pjesë në takime në grup sepse bëhej një studim për dhunën. Në fakt pasi mbaroi konsultimi, ne nuk na takuan më për të na thënë se çfarë ndodhi me atë studim me kontributin tonë.

Ne u ndjemë shumë të vlerësuar që na u mor mendimi, por do të ishte shumë mirë nëse do na thuhej edhe se si u përdor kontributi ynë, në mënyrë që ne të mos ndihemi keq duke u vlerësuar vetëm për një moment konsultimi. Mendoj që kush organizon aktivitete me fëmijët për tu marrë mendimin duhet të kthehet tek ne për të na shpjeguar se si është përdorur ky kontribut. Atëherë do të ndiheshim vërtetë të vlerësuar edhe sikur kemi ndihmuar në diçka më të madhe.”

3

tre





Unë jam **Leonardo Bezhi** dhe e konsideroj pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të të rinjve si një ndër shtyllat bazë mbi të cilat mund të krijojmë ndryshim në aktualitetin tonë. Personalisht kam pasur mundësinë të ndjek dhe të jem pjesëmarrës në shumë aktivitete të ndryshme të cilat kanë kërkuar inputin tim aktiv. Kontribut i cili është vlerësuar dhe ka shërbyer gjithmonë si një pikë e fortë mbështetëse. Gjatë pjesëmarrjes sime si anëtar i "**Zërit 16+ Durrës**", sa herë janë organizuar aktivitete, të gjithë fëmijët janë njohur me ndikimin e përfshirjes së tyre si edhe gjithnjë na është kërkuar mendimi ynë rreth eksperiencës së pjesëmarrjes sonë duke na u kërkuar sugjerimi për përmirësim. Të gjitha rezultatet e punës sonë janë ndarë me ne, në gjuhë të përshtatshme duke na u krijuar kështu mundësia për të dhënë përshtypjet tona në çështje që kanë të bëjnë me ne fëmijët. **Zëri 16 + Durrës**

Pyetje ndihmëse:

- A vlerësohet procesi i pjesëmarrjes?
- A janë të përfshirë fëmijët në këtë vlerësim?
- A u raportohen rezultatet e procesit fëmijëve në një gjuhë miqësore?
- A mendoni se ka mjaftueshëm burime financiare dhe persona të rritur të angazhuar për realizimin e aktiviteteve me pjesëmarrje?



Kriteri #4 - Pjesëmarrja është e sigurtë

Përshkrimi i kriterit:

“Besoj kjo lidhet me faktin se kur marrim pjesë në një aktivitet apo takim ne duhet të ndihemi rehat dhe të mos ndiejmë siklet nga asgjë. Ne duhet të kemi një marrëdhënie besimi mes anëtarëve të tjerë të grupit dhe po ashtu edhe me tërriturit që na drejtojnë. Edhe ambientet ku ne takohemi për aktivitetet duhet të jenë të sigurt që të mos përbëjnë asnjë rrezik për shëndetin tonë por mbi të gjitha që ne të ndihemi mirë dhe të përfitojmë sa më shumë.”





Unë jam **Dorina Zhuka** dhe përgjatë eksperiencës time pranë CLG "**Zëri 16+... Elbasan**" kam evidentuar një respektim maksimal të të drejtave të fëmijëve, veçanërisht për sa i përket pjesëmarrjes së fëmijëve. Në këtë drejtim nevojat tona kanë qenë të mirëplanifikuara para çdo aktiviteti. Ne, si fëmijë pjesëmarrës kemi ndjerë se çdo gjë ka qenë e parashikuar në mënyrë që të reduktohen rreziqet gjatë proceseve ku ne kemi marrë pjesë, duke ndjerë se kujdes i veçantë i është dhënë lirisë së shprehjes dhe risqeve që lidhen me tema sensitive. Një vëmendje e veçantë gjatë kësaj eksperience i është kushtuar dhe mbrojtjes efektive tonën si fëmijë së bashku me identitetin tonë, dhe njëkohësisht aktivitetet janë zhvilluar në hapësira ku ne jemi ndjerë të qetë, të sigurtë dhe të mbrojtur. Në çdo aktivitet ne jemi ndjerë të mbrojtur nga çdo formë dhune apo abuzimi si dhe larg situatave stresuese, duke e bërë sa argëtuese aq dhe produktive procesin e pjesëmarrjes. Informacionet dhe të dhënat tona, së bashku me fotot janë publikuar vetëm me pëlqimim tonë si pjesëmarrës dhe të prindërve tanë, duke qenë vazhdimisht të informuar mbi mënyrën se si mbrohem ne si fëmijë, apo dhe si duhet të reagojmë nëse përballemi me situata rreziku **Zëri 16+ Elbasan**

Pyetje ndihmëse:

- A janë njohur dhe firmosur nga fëmijët, prindërit/ kujdestarët ligjorë, dokumenti përkatës në lidhje me qëllimin e aktivitetit, mënyrën e organizimit, fotografimin, regjistrimin audio dhe video, etj?
- A është përcaktuar personi i kontaktit të cilit duhet ti referoheni për çdo nevojë apo shqetësim? A ndiheni të qetë me të?
- A jeni informuar rreth masave që sigurojnë mirëqenien tuaj fizike dhe emocionale gjatë aktivitetit pjesëmarrës?



Kriteri #5 - Pjesëmarrja është relevante / domethënëse / e përshtatshme

Përshkrimi i kriterit:

“Pjesëmarrja ka lidhje me ato që dimë dhe nuk përfshin gjëra që nuk kanë lidhje me njohuritë tona. Pjesëmarrja duhet të ketë vlerë për ne fëmijët, ku mendimi dhe fjala jonë duhet të merret seriozisht dhe të ketë ndikimin e saj.

Ajo duhet të realizohet duke marrë parasysh tiparet tona, moshën, mendimet, gjendjen fizike dhe mendore, dhe të respektojë personalitetin tonë”





Unë jam **Fioralba Markja** dhe për shumë vjet kam qenë pjesë e Child Led Group "**Zëri 16 + Peshkopi**" një grup i cili mbronte dhe promovonte të drejtat e fëmijëve dhe mbështetej nga organizata "**Save the Children**". Antaresimi im në këtë grup më bëri të kuptoja se çfarë janë të drejtat e fëmijëve dhe kush ka përgjegjësinë për garantimin e tyre si dhe të ndjeja që unë isha një fëmijë i aftë për të kontribuar dhe për të marrë pjesë aktivisht në të gjitha çështjet që kishin lidhje me mua. Më bëri të kuptoj që të rriturit dëgjojnë fëmijët duke siguruar lirinë e tyre për t'u shprehur si dhe marrin në konsideratë mendimet e tyre kur trajtojnë çështje që prekin ata. Nëpërmjet aktiviteteve dhe trajnimeve të ndryshme unë u njoha me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve në të cilën, përpos shumë gjërave, kuptova që pjesëmarrja e fëmijëve përbën një ndër shtyllat dhe parimet bazë të saj. Gjatë atyre viteve janë zhvilluar aktivitete të shumta të cilat bazoheshin në njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e mia për të qenë e angazhuar. Kemi qenë ne fëmijët të cilët planifikonim dhe drejtonim veprimtaritë dhe aktivitetet por sigurisht duke u konsultuar dhe mbështetur nga lehtësuesit e grupit. Çdo aktivitet është zhvilluar duke patur parasysh interesin më të lartë të fëmijës dhe është arritur gjithëpërfshirja e tyre. Metodologjia e punës ka qenë praktikuar duke marrë në konsideratë këshillat tona dhe në asnjë moment nuk janë anashkaluar angazhimet e tjera si shkolla, familja etj. Pjesëmarrja ime në "**Zërin 16+ Peshkopi**" ka qenë një ndër eksperiencat më frytdhënëse për mua, pasi përmirësova dukshëm të shprehurin lirshëm të mendimeve të mia, u informova akoma më shumë në lidhje me të drejtat që u takojnë fëmijëve dhe kuptova fuqinë që unë kisha në realizimin e të drejtave të fëmijëve. **Zëri 16 + Peshkopi**

Pyetje ndihmëse:

- A është ndërtuar procesi i pjesëmarrjes për të qenë një proces i vazhdueshëm apo vetëm një aktivitet i vetëm në një kohë të caktuar?
- A mendoni se aktiviteti bazohet në çështje me interes për ju dhe për të cilin ju keni informacion dhe njohuri?
- A i përgjigjet procesi nevojave tuaja?



Kriteri #6 - Pjesëmarrja është e bazuar në respekt reciprok

Përshkrimi i kriterit:

“Të gjithë mendimet e fëmijëve konsiderohen të rëndësishme dhe merren parasysh. Nuk ka mendim të gabuar, apo shprehje opinioni i cili nuk pranohet në një tryezë diskutimi apo ndarje mendimesh. Ndërsa jemi duke diskutuar me të rritur, qofshin ata prindërit apo mësuesit tanë, ne duhet të trajtohem njësoj dhe të respektohem e të respektojmë atë që shprehim, duke dhënë kohën e duhur secilit.”

6
gjashtë





Unë jam **Agim Gremi** dhe prej katër vjetësh jam pjesë e grupit Zëri 16 + Elbasan. Personalisht kam kuptuar dhe mësuar shumë gjëra rreth monitorimit të të drejtave të fëmijëve dhe advokimit për zbatimin e tyre. Kur dëgjova për herë të parë mbi rolin dhe funksionin e grupit u binda që edhe unë duhej të isha pjesë e grupit. Takimet e fëmijëve organizoheshin pas mësimit ose në fundjavë, gjë që pjesëmarrja në këtë grup nuk do të cënontë zhvillimin e angazhimeve të tjera si shkolla apo kurset ekstra kurrikulare. Gjatë rrugëtimit tim në grupin **Zëri 16+ Elbasan** kam parë se opinionet e të gjithë fëmijëve respektohen dhe merren parasysh në procesin e vendimmarrjes, Secili nga ne, ka qenë i lirë të shprehë mendimin e tij dhe asnjëherë grupi nuk e ka kundërshtuar. Të gjithë fëmijët pjesëmarrës në grup janë respektuar dhe janë ndjerë pjesë e rëndësishme e grupit pavarësisht moshës, gjinisë apo kushteve ekonomike dhe sociale. **Zeri 16 + Elbasan**

Pyetje ndihmëse:

- A do të merren në konsideratë opinionet e fëmijëve në vendimmarrje?
- A kemi patur eksperiencë të tjera të ngjashme dhe çfarë na tregojnë ato?
- A janë konsultuar fëmijët që në fazën e parë të procesit të konsultimit /pjesëmarrjes, a kanë ndihmuar ata në mënyrën e organizimit?
- A është lënë në dispozicion kohë e mjaftueshme për konsultim me fëmijët?
- A mbështeten nismat e fëmijëve në lidhje me çështjet që ata duan të diskutojnë?
- Pas procesit të konsultimit a jeni njoftuar mbi ecurinë e procesit dhe si është përdorur kontributi juaj?



Kriteri #7 - Pjesëmarrja është vullnetare

Përshkrimi i kriterit

“Pjesëmarrja është një nga të drejtat tona, por nuk është e detyrueshme nga askush. Ne marrim pjesë në aktivitete apo shprehim mendimin për çështje që na takojnë pasi zgjedhim se kjo është ajo që duam të bëjmë. Do të ishte mirë të merrnim pjesë në aktivitetet e ndryshme që të jepnim opinionin dhe mendimin tonë për çështjen e cila po diskutohet, ose për të mësuar dhe zhvilluar njohuritë dhe aftësitë tona.”





Unë jam **Bora Selenica** dhe kam nisur të angazhohem si vullnetare dhe advokuese e të drejtave të fëmijëve pranë **Save the Children** gjatë shkollës **9-vjeçare**. Një mikeshë e imja asokohe anëtare e "**Zëri 16+..**" më tregoi për eksperiencën e saj dhe nxiti të unë dëshirën për tu angazhuar. Kështu nisi pjesëmarrja ime vullnetare pranë "**Zëri 16+..**", e bazuar tërësisht në vullnetin tim të lirë. Pa cënuar në asnjë moment studimet e mia, për shumë vite me radhe angazhimi pranë këtij grupi të udhëhequr nga fëmijët ka mbushur një pjesë të mirë të kohës sime të lirë. Kam patur gjithnjë mbështetjen e prinderve dhe lehtësuesve të rritur të grupit për të marrë pjesë në aktivitete dhe takime, për aq kohë sa unë jam ndjerë mirë dhe kam patur dëshirë të angazhohem, duke qenë e lirë të heq dorë në çdo moment. Gjatë pjesëmarrjes sime vullnetare ndër vite pranë "**Zëri 16+..**", kam fituar e zhvilluar aftësi dhe mësuar njohuri të reja.

Zëri 16+ Durrës

Pyetje ndihmëse:

- A u është dhënë hapësirë dhe kohë e mjaftueshme për të shqyrtuar mundësinë/dëshirën për pjesëmarrje?
- A e respektojnë lehtësuesit dëshirën tuaj për tu shprehur pa ju detyruar?
- A jeni informuar se pjesëmarrja është vullnetare dhe se keni të drejtë të lini procesin në çdo moment?
- A është përshtatur procesi i pjesëmarrjes me nevojat, ritmin dhe angazhimet tuaja të tjera?




Kriteri #8 - Pjesëmarrja është gjithëpërfshirëse

Përshkrimi i kriterit:

“Të gjithë fëmijët nga vende të ndryshme, me aftësi të ndryshme, me besime dhe zakone të ndryshme janë të lirë të marrin pjesë. Që kjo të bëhet e mundur, të rriturit duhet të ndihmojnë fëmijët me shqetësimet që mund të kenë për shkak të ndryshimeve që kanë si për shembull gjuha, aftësitë dhe pasiguritë që mund të shfaqin fëmijët.”

8
tetë





Unë quhem **Kristela Pashollari** dhe kam qenë pjesë e grupit **Zëri 16 + Durrës** prej afro një dekade. Gjatë gjithë eksperiencës sime me grupin kam patur mundësinë të takoj dhe bashkëpunoj me të rinj dhe të reja të jashtëzakonshëm, të cilët ishin pjesë e grupit. Një ndër karakteristikat më të bukura të grupit, padyshim ka qenë pjesëmarrja gjithëpërfshirëse në grup. Të rinj dhe të reja të cilët ishin pjesë e grupeve të ndryshme shoqërore, por brenda grupit ishim padiskutim të gjithë të barabartë. Ndër të tjera, në grup mësuam të respektojmë dhe duam njëri-tjetrin pa u diskriminuar për ngjyrën, aftësitë, mundësitë, moshën apo prejardhjen dhe sigurisht të llojmë fort për krijimim e mundësive të barabarta për të gjithë. Grupi ka qenë gjithnjë një familje e madhe, pa paragjykime, pa diskriminime dhe gjithëpërfshirës për fëmijët anëtare të cilët kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm për zbatimin e të drejtave të tyre nga të rriturit. **Zëri 16 + Durrës**

Pyetje ndihmëse:

- A marrin pjesë në proces/ konsultim vetëm nxënës të mirë në mësim dhe nga familje në gjendje më të mirë ekonomike?
- A u jepet e njëjta mundësi të gjithë fëmijëve pa dallim përkatësie gjinore, etnike, aftësie të kufizuar, apo nga zona periferike/fshati?
- A mendoni se janë përfshirë të gjithë grupet e fëmijëve në proces?
- A janë marrë masa (mbështetje për udhëtim, përkthim gjuhësor dhe lehtësues me eksperiencë në punën me fëmijët) për sigurimin e mundësive për pjesëmarrje të këtyre grupeve të fëmijëve?




Kriteri #9 - Pjesëmarrja mbështetet nga të rritur miqësor dhe të mirë informuar.

Përshkrimi i kriterit

“Fëmijët duhet të jenë informuar mirë mbi aktivitetin në të cilin duan të marrin pjesë dhe mbi programin që do të ndiqet. Të rriturit duhet të jenë të pajisur me aftësitë e duhura për të realizuar një proces të lehtë e të kuptueshëm nga vetë ne fëmijët. Të rriturit duhet të dinë mirë të drejtat e fëmijëve dhe t'i respektojnë ato gjatë çdo procesi ku fëmijët përfshihen, flasin dhe shprehin mendimet e tyre.”

9
nëntë





Quhem **Klen Çupi**, i lindur dhe i rritur në Burrel, një qytet i vogël i cili nuk ofron shumë mundësi për fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë. Në Qershor të vitit 2013, vullnetarisht jam angazhuar me grupin **Zëri 16+** në qytetin e Burrelit. Gjatë 5 viteve ku unë isha pjesë e këtij projekti me një rol shumë aktiv, së bashku me fëmijët e tjerë, jemi munduar të japim më të mirën tonë për zbatimin e drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Ne kemi arritur të krijojmë lidhje të forta me institucionet vendore të cilët na kanë mbështetur në aktivitetet tona. Kemi marrë pjesë në vendimet e qeverisë lokale, dhe kemi ndikuar në proceset dhe vendimet me interes për fëmijët. Kemi ndërtuar përgjatë viteve, bashkëpunime të dobishme me Institucionet Vendore dhe Qendrore. Kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, me Këshillat Bashkiakë, me qëllim përfshirjen e zërave të fëmijëve në çështjet që prekin vetë ata. Bashkëpunimi me Këshillat Bashkiakë ka rritur njohuritë e tona mbi politikat lokale dhe proceset e vendim marrjes, si dhe ka fuqizuar interesin dhe angazhimin e tonë për të ndikuar vendimarrësit dhe për të arritur rezultatet më të mira për fëmijët në shkollë dhe në nivel lokal. **Zëri 16+ Burrel**

Pyetje ndihmëse:

- A është shpërndarë informacioni i duhur në lidhje me pjesëmarrjen e fëmijëve si një parim themelor i të drejtave të fëmijëve?
- A janë shpërndarë materiale që ndihmojnë të rriturit të punojnë me fëmijët dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen aktive të tyre?
- A janë trajnuar të rriturit në lidhje me Konventën e të Drejtave të Fëmijëve dhe parimet bazë që përshkojnë atë?
- A mendoni se të rriturit që kanë drejtuar apo lehtësuar aktivitetet pjesëmarrëse kanë një komunikim të mirë, ju bën të ndiheni mirë, të vlerësuar dhe të angazhuar?



DISA NGA FUSHAT KU FËMIJËT DUHET DHE MUND TË MARRIN PJESË

Në diskutim me psikologun/punonjësit social, pranë Bashkisë ose në qendra shërbimesh


- 1- Fëmijët duhet të marrin informacion si për situatën ashtu dhe për mundësitë që i ofrohen dhe në bashkëpunim me punonjës social/psikologun të vendoset dhe për mënyrën më të mirë të marrjes së shërbimeve.
- 2- Fëmijët të shprehin opinionet e tyre në lidhje me cilësinë e shërbimeve që marrin si dhe japin sugjerime për përmirësime të mundshme. Për këtë arsye Save the Children në Shqipëri, ka hartuar një dokument për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror ndaj fëmijëve nëpërmjet konsultimit me vetë fëmijët përfitues të këtyre shërbimeve. Ky dokument duhet të përdoret nga profesionistët kur flasin me fëmijët dhe kërkojnë mendimin e tyre.

Arsim - në shkollë, në kurse apo në kontakte me mësues

Në shkollë fëmijët kanë tashmë një organizëm të njohur me ligj, me anë të të cilit mund të angazhohen e të jenë pjesëmarrës duke shprehur mendime e duke qenë pjesë e vendimeve që merren për ta. Qeveria e Nxënësve mbron dhe promovon të drejtat e nxënësve dhe ndihmon në mbarëvajtjen e shkollës, ajo siguron pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë të nxënësve në vendimet që lidhen me mbarëvajtjen e procesit edukativ dhe jetës shkollorë në përgjithësi. Qeveria e Nxënësve nëpërmjet përfaqësuesve të saj të zgjedhur është pjesë e komisionit të Etikës dhe Sjelljes në shkollë, merr pjesë në hartimin e planeve dhe raporteve të shkollës, ftohet të jetë pjesë e mbledhjeve të këshillit të prindërve dhe mësuesve si dhe është pjesë e bordit të shkollës. Është një mënyrë mjaft e mirë për të qenë pranë saj, e për ta ndihmuar në rolin që ka. Për t'u njohur me llojet e aktiviteteve dhe pjesëmarrjen në shkollë shfletoni librin: **"E Gjetëm Zgjidhjen, është Qeveria e Nxënësve"**

të cilën mund ta gjeni pranë bibliotekës së shkollës ose dhe në faqen e internetit:

<https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Children%27s%20Government%20Book.pdf>



Shëndetësi

Pjesëmarrja dhe angazhimi i fëmijëve do ishte me vlerë sidomos në fushën e shëndetit publik. Ju mund të përfshiheni në kërkime, studime (përdorimi i substancave si: alkooli, droga, duhani tek bashkëmoshatarët), aksesimi në shërbimet parandaluese; roli dhe performanca e mjekut/ stomatologut në shkollë apo në rastin e promovimit shëndetësor. Ju mund të keni bashkëbisedim me moshatarëve dhe të ofroni mendimet dhe opinionet tuaja për një jetë sa më të shëndetshme. Fëmijët më të rritur duke kuptuar më mirë ndjenjat dhe nevojat e fëmijëve më të vegjël, mund të angazhohen në aktivitete stimuluese (përmes lojës, leximit etj) mund të japin një kontribut të vlefshëm në qetësimin e më të vegjëlve apo mbështetjen e tyre kur ata kalojnë momente të vështira.

Drejtësia për të mitur

- Disa nga çështjet kryesore që mund të adresohen për të krijuar një ambient të sigurtë dhe miqësor:
- Shprehni mendimet tuaja profesionistëve që gjenden pranë jush, ata janë aty për t'ju ndihmuar në një situatë të vështirë.
Fëmijët duhet të kërkojnë informacion paraprak mbi situatën, procesin që pritet, pozicionin/ rolin e tyre si dhe efektet që priten. Ata duhet të njohin dhe kuptojnë të drejtat dhe procedurën në mënyrë që të jeni të përgatitur për të shprehur mendimin dhe pozicionin tuaj.
- Ndhuni të lirë të bëni pyetje nëse nuk e kuptoni informacionin që ju jepet.
- Në rast se vendi ku po ju intervistojnë nuk ju përshtatet, kërkoni të ndryshoni ambient. E rëndësishme është të ndiheni mirë, të qetë dhe të keni besim të profesionistët pranë jush.

Në rast se një fëmijë ndodhet për një periudhë të caktuar në një institucion të kryerjes së dënimit, ka të drejtë të jetepjesë e shumë proceseve apo aktiviteteve:


- 1- Vendorsja dhe ndërtimi i programit të rehabilitimit - fëmija duhet të jape mendimin e tij për të përcaktuar mënyrën më të përshtatshme të kujdesit social që do t'i rezervohet atij.
- 2- Edukim, trajnim profesional dhe punë - Qëllimi i edukimit është ta përgatisë fëmijën për mometin e largimit nga institucioni. Për këtë, modeli më i mirë i trajtimit të fëmijës është modeli përkrahës i cili bazohet tek mundësitë e tij prandaj duhet të bëhet në konsultim me vetë fëmijën.
- 3- Koha e lirë - veprimtari rikrijuese të sugjeruara nga vetë fëmijët.
- 4- Feja - fëmijët mund të marrin pjesë ose të refuzojnë çdo formë organizimi fetar.
- 5- Kujdesi mjekësor - konsultimet me fëmijët janë të domosdoshme për të kuptuar gjendjen e tyre fizike dhe mendore.
- 6- Kontaktet me komunitetin - fëmijët duhet të pyeten dhe t'u merren parasysh mendimet në kontakte që duhet të vendosin me anëtarë të tjerë të komunitetit jashtë institucionit.
- 7- Kontrolli dhe ankesat - Fëmijëve duhet t'u njihet e drejta për të folur në kushte konfidencialiteti me çdo njërin nga ata.

Pushteti Vendor - Bashkitë:

Këshillat Bashkiakë janë institucione vendim - marrëse në nivel lokal përgjegjëse edhe për planifikimin e shërbimeve në territorin e tyre. Në këtë kuadër fëmijët si një nga grupet e interesit duhet të konsultohen për të dhënë këndvështrimin e tyre në lidhje me nevojat specifike për shërbime (infrastruktura shkollore, ambiente kulturore apo sportive, etj). Disa Bashki kanë krijuar praktika të konsultimit me qytetarët për çështje të caktuara duke përfshirë dhe fëmijët. Por si mund të forcohet kjo praktikë edhe në përfshirjen e mendimeve të tyre?

Për këtë sigurohuni që në qytetin tuaj po ndiqen hapat e mëposhtëm:

- 1- Njoftimi i fëmijëve - Grupi i fëmijëve organizohet për t'u përgatitur për procesin, informohen dhe njihen me planin
- 2- Puna në grup mbi çështjen ku kërkohet opinioni I fëmijëve (udhëhequr nga lehtësuesi përkatës (psh. mësuesi koordinator I Qeverisë së Nxënësve; lehtësuesi i Qendrës Rinore; drejtuesi i grupit të udhëhequr nga fëmijët; etj)
- 3- Njohja dhe thellimi tek çështja në diskutim
- 4- Prezantimi i ideve, opinionëve, sugjerime nëpërmjet një takimi apo dhe dorëzimit të një materiali të shkruar në formën e një raporti
- 5- Caktimi i përfaqësuesve dhe prezantimi i mendimit në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.



BIBLIOGRAFIA

- 1. Konventa e të Drejtave të Fëmijëve në gjuhën e Fëmijëve**
https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Child%20Rights%20Convention%20for%20%26%20by%20Children%5B1%5D_0.pdf
- 2. Ligjin Nr.18/2017, për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës**
<http://femijet.gov.al/al/ep-content/uploads/2017/07/LIGJI-NR-18-2017-%E2%80%9CP%C3%8BR-T%C3%8B-DREJTAT-DHE-MBROJTJEN-E-F%C3%8BMIJ%C3%8BS%E2%80%9D.pdf>
- 3. Përcaktimi i Interesit më të Lartë të Fëmijës,**
Save the Children Albania <https://resourcecentre.savethechildren.net/sites/default/files/documents/3829.pdf>
- 4. Udhëzuesi "Kriteret e Përgjithshme të Pjesëmarrjes së Fëmijëve**
<https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Kriteret%20e%20%20pjesemarrjes%20se%20femijeve.pdf>
- 5. E Gjetëm Zgjidhjen, Është Qeveria e Nxënësve**
<https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Children%27s%20Government%20Book.pdf>



Save the Children

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);

PO Box 8185, Tiranë - Shqipëri; Tel: +355 4 2261840/ 4 2261929

E-mail: info.albania@savethechildren.org

[https:// albania.savethechildren.net](https://albania.savethechildren.net)



Savethechildrenal



SaveChildrenAlb



savethechildreninalbania